

Hyrje

Qe ne vitin 2016, pyjet dhe kullotat me vendim te Keshillit te Ministrave jane kthyer ne pronësi të bashkive të cilat duhet te ngrenë struktura te specializuara per menaxhmin e pyjeve dhe kullotave. Ne baze te ligjit te pyjeve qeverisja teknike e sektorit të pyjeve dhe të kullotave bëhet sipas planeve të mbarështimit. Te cilat duhet sigurojnë masat për:

- a) Zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore për gjallesat pyjore dhe komunitetet e tyre;
- b) Mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve silvikulturore e të punimeve të tjera, të cilat kanë për qëllim sigurimin e funksioneve ekologjike dhe shoqërore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, vjeljen e prodhimeve pyjore dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimeve pyjore, të burimeve të tjera dhe të gjeneratës së re të masivit pyjor;
- c) Mbarështimin e pyllit dhe të tokës pyjore, për të ruajtur funksionet e tyre, shkallën e ruajtjes së mjedisit pyjor dhe të ripërtëritjes natyrore;
- ç) Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore e natyrore të ngastrave e ekonomive pyjore, në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të gjallesave pyjore dhe të komuniteteve të tyre.

Objektivi kryesor

Të sigurojë menaxhim të qëndrueshëm të ngastrës në të cilën do të bëhen ndërhyrje rigjeneruese me strukture dhe cilësi te mire ne përshtatje me kushtet e stacionit dhe ne përputhje me objektivat e planit te mbarështimit.

Objektivat specifike

- Te optimizojë formen e qeverisjes ne përputhje me nevojat lokale, mundesite e grumbullit pyjor dhe mjedisit per te permiresuar prodhimtarine.
- Te optimizohet nevoja dhe mundesia ekologjike/silvikulturale ne përputhje me rendesine multifunksionale, sociale dhe mjedisore te pyjeve.
- Te permiresojë përdorimin e prodhimtarise se stacionit ne pyjet me funksion prodhues.
- Te permiresojë cilesine dhe gjendjen e pritshme të grumbujve te trungshteve me funksion prodhues
- Punimet të kenë impakt sa më të vogël në dëmtimin e filizërisë së grumbullit
- Të bëhet mundur ruajtja e specieve drunore të rralla që gjenden në këtë objekt
- Ta permiresojë ose mirembaje ne nje gjendje te mire funksionale grumbullin pyjor.

Metoda e punës për ndërhyrje rigjeneruese

Metoda e punës për ndërhyrje rigjeneruese të ngastrave do tëdo të kryhet sipas VKM 438 datë 8.6.2016 ‘‘Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimin të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore ‘‘

Procedurat e punimeve te terrenit.

Ne fillim te punes ne terren, personi pergjegjes per dorëzimin e ngastrës për ndërhyrje rigjeneruese inspektorii zonës dhe pala e interesuar për këto punime bejne nje udhetim te perbashket ne terren per te vleresuar gjendjen aktuale te grumbullit pyjor

Gjate punes ne terren jane te domosdoshme si:

- Kontrolli periodik i punes nga personi i ngarkuar me kete detyre, ashtu dhe
- Udhetimet e perbashketa te te gjithë personave te interesuar.

Ne raste kur shfaqen mendime te ndryshme per çeshtje te caktuara vendimi perfundimtar i takon shefit te sektorit te Administrim Menaxhimit ne Drejtorinë e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit

Ne perfundim te punimeve kryhet perseri nje kontroll i punimeve nga nje grup i perbashket i personavete interesuar. Problemet kryesore diskutohen dhe rezultatet kryesore praqiten dhe diskutohen .

Kjo duhet te arrihet duke perdorur nje silvikulture prane natyres dhe me baze ekologjike, duke ndjekur vazhdimisht objektivat e perdorimit te shumfishte te pyllit me qellim optimizimin e prodhimit (lendes drusore, produkteve te tjera ose perfitimeve te tjera) dhe duke minimizuar shpenzimet dhe gjithë ndikimet e demeshme.

Ndërhyrjet rigjeneruese në ngastrat e përcaktuara duhet te mbajnë parasysh kriteret e mëposhtme:

- Nderhyrjet të jene ne pershtatje me mjedisin lokal dhe karakteristikt e grumbullit.
- Perdorimin e zhvillimit natyral te pyjeve (automatizimi biologjik).
- Te mos demtohet filizëria e instaluar.
- Gjatësia e druve të jetë sipas standartit shtetëror 95 cm deri 105 cm
- Lartësia e druve të stivosura te jetë sipas standartit shtetëror 110 cm
- Gjatësia e trupit të jetë 10 cm mbi gjatësinë e standartit shtetëror.
- 1 nyje për cdo 1 ml në një krah të trupit dhe jo në të gjithë perimetrit e tij.
- Për trupat që kanë kalbëzim deri në 20 % të zbritet volumi i kalbët nga volumi total i trupit
- Të mos dëmtohen speciet e rralla që gjenden në ngastër.
- Prerja e drurëve të mos bëhet në një lartësi të madhe nga sipërfaqja e tokës (1/3 e diametrit).
- Të priten vetëm drurët e përcaktuar nga specialisti i pyjeve në bashki.
- Parcela e cila do ti jepet palës së interesuar të mbrohet dhe të mbajë përgjegjësi nga zjarret dhe prerjet e paligjshme
- Ndërhyrjet rigjeneruse të kryhen brenda afatit të përcaktuar
- Pas përfundimit të ndërhyrjes rigjeneruese ngastrat të pastrohet ku mbeturinat e dala të grumbullohen në një togje me largësi 30-40 m .

Për një zhvillim të qendrueshem të pyjeve duhet permiresuar nepermjet

- Nje nderhyrje me impakt sa më të pakët në grumbullin pyjor.
- Të krijohet kushtet dritësuese për filizërine e instaluar
- Të mos ketë dru të kalbura gjatë dorezimit .

Raportimi dhe Kohëzgjatja

Pala e interesuara që do të merret me punimet rigjeneruese në ngastra do të bëjë raportim të punës cdo 1 muaj për ecurinë e punës duke paraqitur pranë zyrës së menaxhimit rakordimet mujore. Kohëzgjatja e punimeve do të jetë 1 vit. Kjo për arsye së në muajt e dimrit nuk do punohet për arsye të kushteve klimaterike.